



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më ____ . ____ .2024

VENDIM

Nr. 283, datë 29.05.2024

PËR

**CAKTIMIN NË POZICION, NË MËNYRË TË PËRHERSHME, NË GJYKATËN E
POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR TË GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4, nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 162, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr.24, datë 22.05.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vendimin datë 16.05.2024 të Gjykatës së Lartë, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR